




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARI



**REZOLUTË**

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENCISË SË SIGURIMIT  
TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2020**

**Kuvendi i Shqipërisë,**

- Duke njohur e vlerësuar rolin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për sigurimin dhe kompensimin e depozitave të qytetarëve, të vendosura në bankat që operojnë në Republikën e Shqipërisë;

- Duke vlerësuar kontributin e saj në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë së sistemit financiar e bankar;

- Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë agjenci, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e saj me institucionet kombëtare e ndërkombëtare,

**Vlerëson veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në drejtim të:**

- Miratimit të “Platformës për përmirësimin e cilësisë së të dhënave të depozituesve dhe depozitave në sistemin bankar” si një domosdoshmëri për një proces kompensimi të saktë dhe të shpejtë;

- Bashkëpunimit dhe koordinimit me institucionet dhe autoritetet rregullatore për monitorimin e ecurisë së treguesve të anëtarëve të skemës dhe ruajtjes së integritetit të operacioneve të saj;

- Administrimit me efektivitet të mjeteve financiare, duke diversifikuar portofolin me investime në maturitet më afatgjatë;

- Angazhimit të Agjencisë në rritjen e nivelit të edukimit dhe ndërgjegjësimit të depozituesve për përfitimet dhe kufizimet e skemës së sigurimit të depozitave;

- Realizimit të trajnimeve të punonjësve të shërbimit me klientelën, si përcjellësit e parë dhe më të rëndësishëm të informacionit për sigurimin dhe kompensimin e depozitave.

**Kuvendi rekomandon që Agjencia e Sigurimit të Depozitave për vitin 2021 të përmirësojë punën në këto drejtime:**

- Të bashkëpunojë me të gjitha bankat dhe shoqëritë e kursim – kreditit për ndjekjen dhe zgjidhjen e të gjitha problematikave të dala gjatë simulimeve teknike të mëparshme.
- Të përmirësojë kapacitetet monitoruese dhe vlerësuese të Agjencisë duke kryer stres-teste në vazhdimësi për vlerësimin e mjaftueshmërisë së fondit të kompensimit të depozitave në banka.
- Të përmirësojë sistemin e teknologjisë së informacionit të Agjencisë në lidhje me modulet e kryerjes së pagesave në një proces kompensimi dhe të rrisë funksionalitetin e ambientit të raportimit për të mundësuar një paraqitje dhe administrim më të mirë të sistemit të informacionit në Agjenci.
- Të verifikojë në vijueshmëri rezultatet e testeve të dijeve në lidhje me sigurimin dhe kompensimin e depozitave dhe të propozojë materiale trajnuese për përmirësimin e këtyre dijeve për punonjësit e shërbimit me klientin në banka dhe shoqëritë e kursim – kreditit.
- Të vazhdojë bashkëpunimin me anëtarët e rrjetit të sigurisë financiare për ruajtjen e stabilitetit financiar në vend dhe mbrojtjen e interesave të depozituesve.

Miratuar në datën 20.5.2021